



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
Kryesia

Hr 1208/1 Prot

dt. 19.09.24

Rregullore

***Për ngritjen dhe funksionimin e redaksive të periodikëve
shkencorë të Akademisë së Shkencave***

**Neni 1
Objekti**

Objekt i kësaj rregulloreje janë:

1. Parimet bazë të politikës editoriale që zbatohen nga redaksitë e periodikëve që boton Akademia e Shkencave;
2. Mënyra e ngritjes dhe e funksionimit të redaksive të tyre;
3. Kriteret themelore të pranimit, vlerësimit, recensimit, redaktimit dhe botimit të artikujve shkencorë në to.

**Neni 2
Qëllimi**

Qëllimi i kësaj rregulloreje është:

1. Të përcaktojë standardet që duhet të plotësojnë periodikët që botohen nga Akademia e Shkencave sipas kërkesave të njohura ndërkombëtarisht; që garantojnë cilësi, nivel shkencor, periodicitet e aksesueshmëri, me objektiv përfshirjen e tyre në listat e indeksimit të brendshëm a/e ndërkombëtar;
2. Të përcaktojë standardet shkencore dhe teknike që duhet të plotësojnë periodikët që botohen nga Akademia e Shkencave sipas kërkesave të parashikuara në VKM nr. 165 datë 21.3.2018 *Për metodologjinë e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njësive bazë të institucioneve të arsimit të lartë; në rregulloren Për krijimin e regjistrit shtetëror të revistave shkencore që botohen në Republikën e Shqipërisë* miratuar nga ministria

përgjegjëse për arsimin dhe shkencën më 24.1.2023 dhe në vazhdimësi të akteve nënligjore të dala për këtë qëllim;

3. Të caktojë kompetencat e përgjegjësitë e këshillave botues (*publishing board*) dhe të redaksive (*editorial board*), ushtruese të funksionit të Akademisë së Shkencave si ent botues; si dhe detyrimet ndaj organizmave dhe subjekteve shkencore kombëtare e ndërkombëtare që certifikojnë cilësinë dhe nivelin e botimeve periodike shkencore.

Neni 3 Baza ligjore

Kjo rregullore mbështetet:

1. Në Ligjin nr. 53/1019 *Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë*, neni 4 pika 8, neni 5 germa dh dhe neni 12 germa c;
2. Në Statutin e Akademisë, neni 4 pika 8, neni 31 pika 3 dhe neni 48;
3. Në Rregulloren e veprimtarisë botuese të Akademisë së Shkencave, nenet 2, 5, 6, 7 dhe 21;
4. Në rregulloren e Ministrisë së Arsimit dhe Sporteve datë 24.1.2023 nr. prot. 459/2 *Për krijimin e regjistrit shtetëror të revistave shkencore që botohen në Republikën e Shqipërisë* dhe aktet nënligjore të dala për këtë qëllim;
5. Për aspekte të veçanta kjo rregullore mbështetet në Ligjin nr. 35/2016 *Për të drejtën e autorit dhe të drejta të tjera të lidhura me të* dhe në VKM nr. 165 datë 21.3.2018 *Për metodologjinë e procesit të vlerësimit të veprimtarisë kërkimore-shkencore të njërive bazë të institucioneve të arsimit të lartë*.

Neni 4 Parimet e etikës së botimit

1. Periodikët që boton Akademia e Shkencave kanë karakter përzgjedhës;
2. Parimet themelore të etikës së botimit dhe qëndrimi ndaj plagjiaturës e manipulimit përcaktohen dhe i përmbahen Kodit evropian të etikës në kërkimin shkencor, që është pjesë e Statutit të Akademisë së Shkencave;
3. Revistat që botohen nga Akademia e Shkencave mbështeten në parimin e konkurrencës për cilësi dhe origjinalitet. Në procedurat e vlerësimit dhe përzgjedhjes së lëndës për botim redaksitë mbështeten në parimin e paanësisë dhe objektivitetit, jashtë çdo ndikimi e argumenti joshkencor.

Neni 5

Politika editoriale dhe regjistri i periodikëve

1. Në zbatim të politikës së saj editoriale Akademia e Shkencave themelon e boton revista shkencore periodike, me qëllim pasqyrimin në to të veprimtarisë kërkimore-shkencore të saj, të njësive të përhershme dhe të bashkëpunëtorëve të tyre.

Botimet e brendshme jubilarë e përkujtime dhe ato me përmbledhje të artikujve e referimeve të paraqitura në ngjarje a veprimtari shkencore nuk konsiderohen periodikë;

2. Akademia e Shkencave boton këta periodikë shkencorë: *Studia albanica*, *Albanian Journal of Natural and Technical Sciences* (më tej: A-JNTS); *Iliria e Candavia* (botime të Institutit të Arkeologjisë); *Studime historike* (botim i Institutit të Historisë); *Studime filologjike* (botim i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë), *Gjuha jonë* (botim i Akademisë së Shkencave); *Antropologji* (botim i Institutit të Antropologjisë); *Studime për artin* (botim i Qendrës së Studimit të Arteve) e *Albanian studies* (botim i përbashkët në albanologji, sipas vendimit nr. 22 datë 26.2.2024 të Kryesisë së Akademisë së Shkencave);

3. Periodikë të tjerë shkencorë themelohen me vendim të Kryesisë, me propozim të një njësie të kërkim-studimit apo të një komisioni të përhershëm, pas marrjes së mendimit të komisionit / njësisë përkatëse.

Neni 6

Objekti i periodikëve

1. *Studia albanica* botohet nga Seksioni i Shkencave Shoqërore dhe Albanologjike (SSSHA). Ajo ka për qëllim të bëjë të njohur vijimësisht kontributet më cilësore shkencore rrjedhëse të kryera më së pari prej studiuesve shqiptarë, si dhe të albanologëve të huaj, në dijet që janë objekt i këtij seksioni (arkeologji dhe histori; gjuhësi dhe antropologji kulturore; trashëgimi shpirtërore dhe materiale; etnomuzikologji dhe folklor; studime për letërsinë, artin dhe identitetin etj.);

2. A-JNTS është botim periodik i Seksionit të Shkencave Natyrore dhe Teknike (SSHNT). A-JNTS ka për qëllim të bëjë të njohura arritjet më cilësore shkencore të studiuesve të fushave të shkencave natyrore e atyre teknike, që janë objekt i SSHNT, në bashkësinë gjegjëse brenda dhe jashtë vendit; të mbajë dhe rikonfirmojë në vijimësi lidhjet mes studiuesve shqiptarë e të huaj të këtyre fushave;

3. Revista *Iliria* është botim i Institutit të Arkeologjisë pranë Akademisë së Shkencave dhe shërben në vijimësi si pasqyrë e mendimit shkencor e të

veprimtarisë hulumtuese kërkimore e studimore, kryesisht të Institutit të Arkeologjisë si dhe të bashkëpunëtorëve të tij e institucioneve homologe;

4. Revista *Candavia* është botim i dedikuar i Institutit të Arkeologjisë pranë Akademisë së Shkencave për raportet vjetore të kërkimeve arkeologjike në terren për të gjitha periudhat: nga prehistoria, antikiteti e antikiteti i vonë dhe mesjeta, të kryera çdo vit në territorin shqiptar nga Instituti i Arkeologjisë a në bashkëpunim;

5. Revista *Studime historike* është botim i Institutit të Historisë pranë Akademisë së Shkencave, tribunë shkencore në fushën e studimeve historike të veprimtarisë në tërësi të Institutit të Historisë, si dhe të bashkëpunëtorëve të tij e institucioneve homologe;

6. Revista *Studime filologjike* është botim shkencor i Institutit të Gjuhësisë dhe Letërsisë pranë Akademisë së Shkencave, tribunë shkencore në fushën e studimeve filologjike, kryesisht të Institutit të Gjuhësisë dhe të Letërsisë, bashkëpunëtorëve të tij e institucioneve homologe;

7. Revista *Gjuha jonë* është botim shkencor-popullarizues i Akademisë së Shkencave si tribunë e përpunimit dhe përhapjes së njësive të shqipes së shkruar në gjithë hapësirën e përdorimit të saj;

8. Revista *Antropologji* është tribunë shkencore e Institutit të Antropologjisë pranë Akademia e Shkencave e profilizuar për artikuj e studime në fushën e antropologjisë kulturore, pasqyruese e punimeve të institutit, bashkëpunëtorëve e institucioneve homologe;

9. Revista *Studime për artin* është botim i Qendrës së Studimit të Arteve pranë Akademisë së Shkencave, me fokus të veçantë artet tradicionale e bashkëkohore; pasqyrim i studimeve më të spikatura në këtë fushë;

10. Revista *Albanian studies* është tribunë shkencore e Akademisë së Shkencave; paraqet në gjuhën angleze kontributet më profesionale të mendimit shqiptar brenda vendit, kryesisht të punonjësve kërkimore-shkencorë të instituteve të albanologjisë.

Neni 7

Periodiciteti dhe aksesi

1. Revistat shkencore të Akademisë së Shkencave dhe të instituteve e qendrave pranë saj botohen rregullisht dy herë në vit dhe dalin fillimisht online (në linjë) me akses të lirë, gjegjësisht brenda muajit qershor (numri i parë) dhe brenda dhjetorit (i dyti). Përfundimisht nga ky rregull, një herë në vit, botohen revistat sipas pikave 3, 4, 8 e 9 të nenit 6 të kësaj rregullorje, për të cilat muaji i daljes përcaktohet nga redaksia përkatëse;

2. Për numrat jashtë këtij periodiciteti, që formohen specifilisht nga kontribute shkencore të pjesëmarrësve në simpoziume, kuvende apo konferenca shkencore të organizuara nga Akademia e Shkencave, vendosin këshillat drejtues ose redaksitë. Këta numra quhen *numra specialë* e llogariten si *numra shtesë (supplement)* në renditjen progresive të tyre;
3. Mosrespektimi i periodicitetit dhe i muajit të botimit cenon reputacionin e revistës, besueshmërinë e rankimin e saj dhe konsiderohet shkelje e rëndë. Masat për këtë përcaktohen në nenin ... të kësaj rregulloreje.

Neni 8 Gjuha e botimit

1. Revistat shkencore *Studia albanica*, *A-JNTS* e *Albanian studies* botohen në gjuhën angleze. Revistat e tjera botohen shqip me përmbledhje të artikujve në anglisht. Botimi në të dy gjuhët vendoset nga redaksia përkatëse, me miratim të Kryesisë;
2. Në *numrat specialë* kontributet shkencore të studiuesve të huaj mund të botohen edhe në gjuhët e pranuara paraprakisht për referim nga organizatori në eventin përkatës. Ky përjashtim mund të bëhet edhe në raste shumë të veçanta nga redaksitë e revistave që dalin në shqip për botimin e një artikulli në anglisht me përmbledhje shqip.

Neni 9 Kryeredaktori

1. Kryeredaktori është drejtuesi e përgjegjësi kryesor për mirëfunksionimin e redaksisë së periodikut përkatës; ai *thërret e drejton mbledhjet* e redaksisë dhe *përgjigjet për politikën editoriale*; organizon punën për përgatitjen e numrave vijues për botim, duke përfshirë: *miratimin e propozimeve për recensuesit*; ndryshimet në strukturën e revistës dhe *renditjen e artikujve në rubrika* numër pas numri; si dhe për dhënien e pëlqimit e verifikimin e publikimit *online* dhe të hyrjes në shtyp;
 2. Kryeredaktorët, për revistat e cituara në pikat 1 dhe 2 të nenit 6, përcaktohen sipas Statutit të Akademisë së Shkencave (neni ...);
- Drejtorët e instituteve dhe drejtuesi i Qendrës së Studimit të Arteve janë kryeredaktorë të revistave që botohen nga njësia që drejtojnë sipas përcaktimeve në nenin 6 të kësaj rregulloreje. Me propozim të drejtuesit të njësisë Kryesia mund të ngarkojë një person tjetër si kryeredaktor;

3. Kryeredaktori i revistës *Albanian studies* dhe ai i revistës *Gjuha jonë* caktohen nga Kryesia e Akademisë. Kryeredaktori i revistës *Candavia* caktohet nga Kryesia, me propozim të drejtorit të Institutit të Arkeologjisë.

Neni 10

Redaksitë dhe këshillat botues

1. Redaksia (*editorial board*) dhe këshilli botues janë dy organet kryesore drejtuese të zbatimit të politikës botuese të Akademisë së Shkencave për përgatitjen për botim të periodikut përkatës dhe aksesin e tij pas botimit. Çdo revistë ngre redaksinë e vet, ndërsa ngritja e këshillit botues është e detyrueshme vetëm për periodikët që dalin në anglisht sipas kësaj rregulloreje;

2. Anëtarët e redaksisë propozohen nga kryeredaktori e emërohen nga Kryesia. Numri i tyre është 9-15. Redaksia ka anëtarë të *brendshëm* dhe *anëtarë të jashtëm*. Anëtarët të jashtëm konsiderohen gjithë ata që nuk janë pjesë e Asamblesë së Akademisë së Shkencave ose e personelit akademik të njësive të përhershme. Në të gjitha rastet, anëtarët e jashtëm përbëjnë shumicën në redaksi. Anëtarët me qëndrim të përhershëm brenda vendit përbëjnë jo më pak se dy të tretat e redaksisë. Anëtarët e jashtëm zgjidhen nga radhët e studiuesve me tituj akademikë *profesor* dhe/ose *profesor i asociuar*. Në për zgjedhjen e anëtarëve të jashtëm të redaksisë merret mendim edhe nga drejtuesit e institucioneve të arsimit të lartë, në bazë të marrëveshjeve të nënshkruara;

3. Këshilli botues (*publishing board*) përbëhet nga 9-21 anëtarë, të gjithë me titull shkencor së paku *profesor i asociuar*. Në çdo rast, numri i anëtarëve të këshillit botues duhet të jetë tek. Drejtorët e njësive të përhershme janë anëtarë të këshillit përkatës për shkak të funksionit, nëse kanë titullin akademik *profesor i asociuar* a *profesor*. Të paktën pesë anëtarë të këshillit botues janë studiues të huaj me titull *akademik* ose *profesor*;

5. Përgjegjësia për cilësinë shkencore të periodikut është e redaksisë dhe këshillit; respektimi i kësaj rregulloreje prej tij është përgjegjësi e redaksisë.

Neni 11

Sekretari shkencor / koordinatori shkencor shkencor i periodikëve

1. Sekretari shkencor / koordinatori shkencor për revistat që botohen nga Akademia e Shkencave propozohet nga kryeredaktori e miratohet nga bordi editorial;

2. Sekretari shkencor / koordinatori shkencor i periodikëve kryen detyrat sipas përshkrimit në rregulloren *Për funksionimin e administratës në Akademinë e Shkencave*.

Për revistat në gjuhë të huaj (*Studia albanica*, *A-JNTS* dhe *Albanian studies*), sekretari shkencor / koordinatori shkencor duhet të jetë njohës në nivel të lartë të gjuhës së publikimit të tyre, të dëshmuar me diplomën e mbrojtjes së saj si gjuhë e huaj në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja të UT ose me dëshmi të certifikimit ndërkombëtar në njërën prej platformave TOEFL ose IELTS;

3. Sekretari shkencor / koordinatori shkencor mban lidhjet midis anëtarëve të redaksisë, autorëve e recensuesve; mbledh dhe koleksionon lëndën e numrit të ri në një dosje të veçantë; verifikon respektimin e rregullave formale në paraqitje e afate; i paraqet periodikisht kryeredaktorit gjendjen e lëndës që disponohet për numrin e ri; përgatit mbledhjet e redaksisë sipas rendit të përcaktuar nga kryeredaktori; i propozon përmbajtjen fillestare kryeredaktorit e njofton me pëlqim të tij anëtarët e redaksisë me një relacion paraprak për prurjet; bën kodifikimin e artikujve sipas kriterëve të *Universal Decimal Classification* (UDC) - *katalogimit dhjetor universal* (KDU), si dhe ndjek redaktimin e lëndës së numrit të radhës nga redaktori i ngarkuar pas miratimit nga redaksia;

4. Redaktori gjuhësor mban përgjegjësi për njësinë dhe qartësinë e shqipes dhe për saktësinë terminologjike. Redaktorët gjuhësor caktohen me vendim të kryesisë në konsultim me kryeredaktorët.

Neni 12

Mbledhja e bordit dhe e redaksisë

1. Mbledhja e redaksisë (*editorial board*) thirret dhe drejtohet nga kryeredaktori. Mbledhja e saj mund të propozohet edhe nga tre anëtarë. Redaksia mblidhet jo më pak se dy herë për çdo numër;

2. Mbledhja e redaksisë zhvillohet me praninë e më shumë se gjysmës së anëtarëve të saj;

3. Vendimet merren me shumicën e votave të të pranishmëve. Votimi bëhet i hapur dhe numri i votave pro vendimmarrjes duhet të jetë jo më pak se një e treta e votave të anëtarëve.

Neni 13

Burimet e lëndës shkencore

1. Fillimi i punës për përgatitjen e numrit vijues të periodikut shkencor shpallet me një *thirrje publike për kontribut*, në shqip e anglisht, që

konceptohet nga vetë redaksia. Përmbajtja e numrit propozohet mbi bazën e prurjeve shkencore të depozituara në redaksi nga autorët e interesuar në përgjigje të *thirrjes për kontribut*;

2. Redaksitë e revistave *Studia albanica* dhe *Albanian studies* mund të përzgjedhin për përkthim e botim artikuj të publikuar së fundmi në shqip në periodikë shkencorë ose pjesë të studimeve monografike, për shkak të rëndësisë së tyre për studiuesit e huaj. Përkthimi e botimi i tyre bëhet me pëlqimin e autorëve;

3. Për revistën *Studia albanica* kanë përparësi kontributet që lidhen me paradigmen bazë të shkencave albanologjike ose që u kushtohen çështjeve të debatueshme në albanologji gjatë periudhës rrjedhëse. Redaksia nxit debatin shkencor dhe fton për kontribute ekskluzive edhe albanologë nga radhët e studiuesve të huaj;

4. Revista *Albanian studies* boton të përkthyer artikujt më të spikatur të zgjedhur nga periodikët shkencorë të instituteve të albanologjisë të Akademisë së Shkencave dhe nga revistat për studime shqiptare në Kosovë, në Maqedonisë së Veriut, në Mal të Zi e në diasporë. Artikujt e zgjedhur duhet ta kenë kaluar procedurën e recensionimit kur janë botuar në gjuhën shqipe.

Neni 14

Struktura e revistave

1. Rubrikat e përhershme të periodikëve shkencorë të Akademisë së Shkencave respektojnë raportet dhe renditjen sipas standardeve të *International Standard Serial Number* [më tej: ISSN] dhe janë: 1. Artikujt shkencorë; 2. Recensionet e librave shkencorë/akademikë;

2. Raportet mes dy rubrikave të përhershme në tërësinë e lëndës së numrit janë: a). Artikuj shkencorë - jo më pak se dy të tretat e vëllimit; b). Recensione, kritikë e bibliografi rreth botimeve më të rëndësishme akademike-universitare gjatë periudhës rrjedhëse sipas fushave brenda dhe jashtë vendit - deri në një të tretën e vëllimit;

3. Në revistat në gjuhë të huaj botohen jo më shumë se 10 (dhjetë) artikuj shkencorë dhe jo më pak se 6 (gjashtë) artikuj shkencorë të përzgjedhur.

Neni 15

Struktura e artikullit

1. Artikulli shkencor duhet të përmbajë *emrin e mbiemrin* e autorit, *adresën e tij të punës*, *abstraktin* me jo më shumë se 300 fjalë;

2. Struktura e masa e artikullit shkencor duhet të jetë në përputhje me kriteret e standardet e kërkuara, të specifikuara nga redaksitë përkatëse.

Neni 16

Shqyrtimi e miratimi i lëndës

1. Këshilli botues mbledhet për të bërë një vlerësim paraprak të lëndës që disponohet për numrin e radhës dhe për të autorizuar redaksinë të fillojë procedurën e recensioimit. Këshilli botues nuk ndërhyr më tej;
2. Rendi i ditës e data e mbledhjes së redaksisë njoftohen nga kryeredaktori a sekretari shkencor / koordinatori shkencor jo më pak se një javë përpara;
3. Lënda e disponuar u shpërndalet paraprakisht nga kryeredaktori a sekretari shkencor / koordinatori shkencor anëtarëve të redaksisë sipas fushave të ekspertizës;
4. Anëtarët e redaksisë relatojnë në mbledhje nëse artikujt janë të pranueshëm dhe rekomandojnë recensuesit. Refuzimi prej një anëtari të redaksisë për artikullin e paraqitur argumentohet me shkrim;
5. Numri i recensuesve është së paku dy për çdo artikull;
6. Nëse raportet midis disiplinave ose një interes shkencor i rëndësishëm e kërkon, si dhe në rastet kur lënda e disponueshme është e paplotë, redaksia vendos për garantimin e artikujve shtesë;
7. Mbledhja e dytë e rregullt e redaksisë është vendimmarrëse dhe bëhet pas njohjes me vlerësimin e recensuesve, që u qarkullohen paraprakisht anëtarëve nga redaktori shkencor i revistës. Në mbledhjen e dytë merret vendim për tryezën e lëndës, ndarjen e saj në rubrika, renditjen dhe ndryshimet e mundshme për frontespice;
8. Anëtarët e jashtëm të redaksisë gëzojnë të drejtën e një shpërblimi të arsyeshëm për çdo mbledhje, në masën që caktohet nga Kryesia, me propozim të grupit të vlerësuesve që funksionon pranë këshillit të botimeve.

Neni 17

Recensuesi dhe recensioimi

1. Recensuesit e artikujve që botohen në të gjithë periodikët shkencorë të Akademisë së Shkencave zgjidhen nga redaksitë përkatëse, *në përputhje me parimin e kompetencës shkencore në fushën e ekspertizës*. Recensuesit caktohen në mbledhjen e redaksisë. Të paktën një recensuesit është i jashtëm. Recensuesit përfundojnë vlerësimin e artikullit brenda dy javëve;

2. Redaksitë konceptojnë dhe miratojnë formularin standard të recensionimit, që përfshin pyetjet themelore për vlerën e kontributit, origjinalitetin, përputhshmërinë me prioritetet e periodikut, përjashtimin e konfliktit të interesit dhe mangësitë e mundshme;

3. Marrëdhëniet e redaksisë me autorët dhe recensuesit ndërtohen sipas parimeve dhe procedurave ndërkombëtare të standardit të vlerësimit *peer review (refereeing)* dhe *peer learning*, në përputhje me kërkesat e dokumentit e përbashkët *The Open Method of Coordination in Research Policy*, miratuar nga Bashkimi Europian më 1999;.

4. Redaksia ruan fshehtësinë e autorësisë për recensuesit (vlerësuesit e jashtëm) dhe anasjelltas: fshehtësinë nominale të recensuesit për autorin;

5. Redaksia mund të krijojë një rrjet të përhershëm vlerësuesish të jashtëm (recensuesish). Kur mbi bazën e recensionimit të parë nuk është e mundshme të merret vendim, redaksia kërkon recensione shtesë.

Neni 18

Standarde teknike të njësuar

1. Formatimi teknik i tekstit që botohet në periodikët e Akademisë së Shkencave (lloji i shkronjës, madhësia, bardhësitë, ndërlinjat) vendoset nga redaksia, e cila zgjedh dhe shpall publikisht në faqen zyrtare të saj një nga sistemet e njohur ndërkombëtarisht të citimeve dhe bibliografisë më së paku gjashtë muaj para miratimit të lëndës së numrit vijues;

2. Për revistat që botohen në gjuhë të huaj zbatohet sistemi *Chicago Style*.

Neni 19

Indeksi

1. Periodikët shkencorë të Akademisë së Shkencave botohen me ISSN dhe janë revista të indeksuara sipas standardit ndërkombëtar që konfirmohet nga ISSN. Redaksia respekton kërkesat formale të ISSN për paraqitjen teknike të revistës. Periodikët në gjuhë të huaja pajisen edhe me *e-ISSN*;

2. Artikujt shkencorë të periodikëve në gjuhë të huaj pajisen me *doi (digital object identifier)*.

Neni 20

Aksesi

1. Periodikët shkencorë të Akademisë së Shkencave publikohen rregullisht çdo gjashtë muaj, në qershor e në dhjetor, në fillim në formatin *online*, sipas përcaktimeve në rregulloren e miratuar nga ministria përgjegjëse për arsimin e shkencën sipërcituar. Publikimi bëhet në faqen digjitale të secilit

periodik. Për botimin e rregullt *online* respektohen kërkesat e nenit 6 të rregullores së sipërcituar të ministrisë përgjegjëse për arsimin e shkencën *për periodikët shkencorë e rankimin e tyre sipas kriterëve në nivelet C, B e A;*

2. Periodikët u përgjigjen kërkesave të njohura ndërkombëtarisht të pranuara nga *Open access* dhe kanë si qëllim imediat të regjistrohen në njërën nga listat që e garantojnë këtë status: *Scopus database, Web of Science, Tempus List* dhe / apo *Thomson Reuters;*

3. Botimi i periodikëve realizon të njëjtat kërkesa dhe procedura që bëjnë të mundur verifikimin e cilësisë dhe origjinalitetit të tyre përmes treguesit ndërkombëtar IF (*Impact factor*).

Neni 21 Shpërblimi

1. Autori ka të drejtën e një honorari, që llogaritet sipas tarifave në fuqi;
2. Për shkak të specifikave terminologjike dhe të rëndësisë që ka cilësia e përkthimit për komunikim me rrjetin e studiuesve jashtë vendit, artikujt që botohen në revistën *Studia albanica* pranohen edhe në gjuhën shqipe. Përkthimi bëhet nga ekspertë të certifikuar të gjuhës përkatëse në nivelin C1 dhe porositet nga enti botues;
3. Kur artikulli përkthehet nga enti botues, autori gëzon të drejtën e një shpërblimi të pjesshëm;
4. Anëtarët e redaksisë dhe autori i artikullit gëzojnë të drejtën e një kopjeje të numrit. Autorit të artikullit i jepen edhe pesë separate. Recensuesit i jepet separati i artikullit që ka vlerësuar.

Neni 22 Dispozita kalimtare

1. Me miratimin e kësaj rregullorje kryetarët e seksioneve propozojnë brenda dy muajsh përbërjen e re të redaksive (*editorial board*) dhe të këshillave botues (*publishing board*). Kryesia miraton përbërjen e re të tyre;
2. Rregulla të mëparshme për mënyrën e ngritjes dhe funksionimit të redaksive të periodikëve dhe për politikën editoriale të tyre, në rastin kur nuk pajtohen me këtë rregullore, shfuqizohen;
3. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Akademisë së Shkencave shqip e anglisht.

Akad. Skënder GJINUSHI
KRYETAR

